



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)

KOMUNA E KLINËS

KUVENDI I KOMUNËS

01. Nr. 007-5001/15

KLINË, 27.10. 2014

### PROCERVEBAL

I SEANCËS SË IX-të TË KUVENDIT TË KOMUNËS, MBAJTUR MË 27.10.2014, NË ORËN 10:00,  
NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, Kryesuesi i Kuvendit, dr. Haxhi Ibishi, nënkyretari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e Kuvendit, drejtorët e drejtive, Zyra ligjore, OSBE, OJQ-të, mediet etj. Seancën e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe iu uroi mirëseardhje në këtë seancë të KK. “E keni marrë rendin e ditës, hapi diskutimin”, tha kryesuesi.

Prend Buzhala, tha se unë desha t'i prezantoj vetëm dy shqetësime, pasi që vij nga Komision i kulturë: “Është mirë që Komuna ta ketë një sqarim: veprimtaria kulturore duhet të trajtohet në mënyrë institucionale e jo në mënyrë burokratike, për shkak se nganjëherë njerëzit të kulturës marrin pjesë në veprat e ndryshme jashtë Komunës, e cila nuk është në gjendje t'u përgjigjet në mënyrë financiare këtyre veprat e. Ajo logika e kërcenimeve dhe ndjekjes së njerëzve të kulturës ka ekzistuar deri në vitet 1999, tashtë nuk duhet, përkundrazi duhet të përshënditet e jo të kërcenohet nga njerëz brenda Komunës. Unë po e barti këtu atë shqetësim, përndrysht vetëm ia vlen të theksoj se kultura e ka lidhë Komunën e Klinës me Gjirokastrën, me Vlorën, me Lezhën me krejt meset tjera, sepse nuk e njohur askush, madje as Klinën nuk e kanë ditur ku gjendet. Prandaj, duhet të jeni mirënjohës në këtë aspekt. Nëse s'e ka paranë të mos jetë pengesë, e para. E dyta, një shqetësim tjetër për shkak të kuadrit të madh të të rinxve që janë të papunë, po vërej si fenomen një dukur negative se njerëzit nuk flasin më, sepse frikësohen të flasin, me Prendin, ose me iks personin, kjo i ngjet diku viteve të ‘80-ta kur njerëzit kanë ikur nga unë dhe nuk kanë pasur guximin të flasin. Unë nuk mendoj askënd ta luftoj, mirëpo konsideroj se nuk na nevojitet neve si sjellje qytetare”, theksoi prof. Buzhala.

Haxh Ibishi, sqaroi anëtarin Buzhala që përmes grupit Grup parlamentar që përfaqëson “3 Plus”, keni mundësi të bini kërkesën e njëjtë për interpelancë për Drejtorinë e Kulturës, përkatësisht drejtoren gjegjëse “Prandaj, u shpreh kryesuesi, jo vetëm juve që jeni në krahun tim të majtë, por edhe në të djathtë, të gjitha GP për shqetësimet që kanë qytetarët edhe subjektet edhe politike le të kalojnë nëpër institucione. As unë as kryetari nuk kemi asnjë pengesë që t'i vendosim debatet brenda këtyre institucioneve”, shtoi kryesuesi.

Bozhidar Sharkoviq, tha se në pikën, Të ndryshme, të përfshihen disa informacione rreth disa ngjarjeve që kanë ndodhur kohëve të fundit në bashkësinë serbe në Komunën e Klinës. Anëtari Sharkoviq e arsyetoi kërkesën.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës me plotësimin.

Me vota unanim e miratua ky

RENDI I DITËS

- 1. Arsyetimi i mungesave,**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i dy procesverbaleve të seancave të kaluara,**
- 3. Shqyrtimi dhe miratimi i preferencave të KPF-së të dt.13.10.2014,**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-programit për banim social për periudhën 2013-2016 (ref. Nga Drejtoria për Urbanizëm),**
- 5. Interpelanca nga drejtori i DKA-së rreth fillimit të viti shkollor 2014-2015,**
- 6. Të ndryshme: Kërkesa e anëtarit Sharkoviq dhe disa çështjeve rreth ngjarjeve që kanë ndodhur kohëve të fundit në bashkësinë serbe.**

**Pika e parë, Arsyetimi i mungesave.**

Kryesuesi sqaroi se prezent janë 25 anëtarë, nuk kam asnjë arsyе për mungesën e 2 anëtarëve.

**Pika e dytë:** Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të seancës së kaluar.

Haxhi Ibishi, sqaroi se një procesverbal i seancave të kaluara është kthyer në përpunim dhe sot e keni marrë të përpunuar, procesverbalin e seancës së fundit dhe të asaj paraprake. Kryesuesi hapi debatin.

Arben Limani, tha se te procesverbali i seancës së fundit, unë kërkoj që të bëhet një plotësim te faqja e parë, aty është shtrembëruar ajo që kam kërkuar gjatë prezantimit. “Këtu është evidencuar që “anëtarri Fadil Gashi në emër të Grupit të LDK-së ka përgatitur një material rreth Fabrikës së ujit”. Domethënë, Fadil Gashi, nuk ka përgatitur material, por nga Fadil Gashi është kërkuar që nga ekzekutivi të përgatitet një material për Fabrikën e ujit, vetëm këtë përmirësim”, shtoi anëtarri Limani.

Ramiz Rrusta, tha se edhe unë kam një koment: në debatin me publikun që kemi mbajtur, më 24.9.2014, atje ku unë kam prezantuar shqyrtimin e projekt-buxhetit për 2015-2017, sigurisht e keni përpara, është lëshuar një gabim, sigurisht, ku thotë që buxheti komunal për vitin 2015 është rreth 2 milionë euro. “Është gabim, ndoshta teknik më tepër, sepse unë kam thënë se buxheti për investime kapitale është 2,70,681 euro, ndërsa buxheti për vitin 2015 kam shumë prej 8,346,381 euro”, tha drejtori Rrusta.

Enver Gashi, tha se edhe të diskutimi im është lëshuar një gabim, të themi teknik, në faqen nr. 4, nuk kam thënë “fjalime”, por kam thënë: “fjala ime”.

Pasi nuk pati më debate, Kryesuesi vuri në miratim procesverbalet e seancave të fundit me korrigimet e bëra nga anëtarët e Kuvendit.

**Me vota unanim e miratuan procesverbalet e seancave të fundit.**

**Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i preferencave të KPF-së të dt.13.10.2014.**

Kryesuesi foli rreth preferencave të KPF-së të datës 13.10.2014. Vuri në miratim (në pak) preferencat e KPF-së.

**Me vota unanim e miratuan preferencat e KPF-së të dt. 13.10.2014.**

**Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-programit për banim social për periudhën 2013-2016 (ref. Nga Drejtoria për Urbanizëm).**

Kryesuesi foli rreth pikës së rendit të ditës. Fjalën e barti te zyrtari i lartë i Drejtorisë së Urbanizmit, z. Ali Gashi.

Ali Gashi, zyrtar i lartë i drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit prezantoi Draft – programin për banim social për periudhën 2013-2016.

Kryesuesi vuri në miratim i Draft-programin për banim social për periudhën 2013-2016.

**Me vota unanim e miratua Draft-programi për banim social për periudhën 2013-2016.**

**Pika e pestë: Interpelanca nga drejtori i DKA-së rreth fillimit të viti shkollor 2014-2015.**

Kryesuesi Ibishi lexoi Rregulloren e punës së Kuvendit, përkatësisht nenin 24, rreth interpelancës.

**Arben Limani** (në emër të Grupit të anëtarëve të LDK-së), “Grupi i asamblistëve të LDK-së duke i parë parregullsitë e shumta që janë bërë në konkursin publik para fillimit të vitit shkollor 2014-2015, ka shprehur disa shqetësimë qysh në seancën e kaluar të cilat i ka adresuar në DKA me shkrim, në fakt, kemi kërkuar edhe sqarime me shkrim për këtë seancë në mënyrë që të pajisemi me të dhënat të cilat i kemi kërkuar si Grup kuvendor. Shqetësimet tona kryesisht kanë qenë të lidhura me konkursin publik për mësimdhënës dhe kuadrin e pranuar për vitin shkollor 2014/2015. Kemi kërkuar si grup që të na sigurohen listat e gjithë atyre që kanë konkurruar dhe kandidatëve që janë pranuar në konkursin e shpallur, dhe ashtu kemi kërkuar përgatitjen arsimore të kuadrit të pranuar në bazë të konkursit publik, të dt. 14.7.2014. Kemi kërkuar sqarime me shkrim mbi arsyen e mosangazhimet të punëtorëve me drejtime arsimore, si dëshmi kemi mbetjen jashtë sistemit të arsimit të shumë kuadrore që kanë edhe më shumë se 30 vjet përvojë pune. Kemi kërkuar po ashtu sqarime me shkrim për pranimin e kuadrit arsimor pa konkurs publik. Besoj që këto sqarime drejtori sot do të na jap. Prapë vërejtja jonë drejtohet në atë që ne kemi kërkuar që t'i kemi edhe me shkrim që t'i shohim edhe ne si asamblistë, por besoj se drejtori do të na jap edhe të dhëna që i kemi kërkuar”, nënvozoi anëtarri Limani.

**Hajdin Morina**, referoi rrëth rrjedhave në arsim dhe ecurive të fillimit të vitit shkollor 2014/2015 në shkollat e Komunës së Klinës. “Fillimi i vitit shkollor ka filluar sipas kalendarit të MASHT-it. Normalisht që ka filluar në kushte më të mira, aftësi më të mëdha dhe mjete më të mëdha didaktike. Normalisht nuk duhet të vetëkënaqemi sepse gjithmonë vlejnë investimet, që krahasuar me vitet tjera është një punë më e madhe. Çka ka risi në këtë vit shkollor? Tri shkolla të Komunës së Klinës janë në programin pilot të zbatimit të kurrikules së arsimit e cila parashihet të zbatohet pas një viti ose dy në të gjitha shkollat e Kosovës, shkolla e Grabanicës, shkolla Profesionale dhe Gjimnazi, klasat e 10-ta dhe klasat parafillore I-VI, iu kanë nënshtruar procesit të pilotimit të kurrrikules. Arsimtarët që japid mësim në këto klase janë duke ndjekur trajnimet intensive në Pejë dhe po vazhdon mirë. Sa për tjera jeni të njoftuar, me fillimin e ndërtimit të disa objekteve shkollore, që nuk janë vetëm pjesë e interesimit të DKA-së, por edhe e pushtetit komunal, Kuvendit komunal dhe asamblistëve. Është filluar me zgjerimin e hapësirave të reja në Jashanicë dhe në Përqevë, pritet së shpejti edhe fillimi ndërtimit të objektit në Këpuz, për çka po bëhet një punë e mirë edhe në përputhje me ligjin për arsyen se në shkollat e Republikës së Kosovës synohet që shkollat të punojnë në një ndërrim, që të ketë efekt më shumë mësimi. Dhe falë investimeve në arsim 6-7 shkolla po punohet në një ndërrim qysh tash. DKA është ballafaquar edhe më sfida, një nga sfidat e këtij viti shkollor ka qenë mungesa e klasave të XIII-ta për këtë vit, që ka shkaktuar normalisht probleme që është dashur të ndihmohet edhe me ndihmesën e MASHT-it, ku mbi 400 nxënës është dashur të janë në vitin XIII sivjet nuk janë. Ju e dini që rrogat për punëtorët e arsimit ndahen në kokë të nxënësve dhe kurdoherë ne do të ballafaqohemi me këtë problem, edhe pse për 2015 buxheti është i ndarë por numri i sivjetmë i nxënësve është më i vogël se sa i vitit të kaluar, duke pasur parasysh një rënie normale e nxënësve për çdo vjet në KK, për vitin 2016 do të ketë probleme, sidomos në paga, për arsyen se sivjet sipas shënimave më të fundit janë të regjistruar 9022 nxënës, vitin e kaluar kanë qenë 9535, sivjet janë 513 më pak, që kur të planifikohet buxheti për 2016, 20 punëtorë arsimorë do të kemi më pak. Kemi punuar në këtë drejtim, kemi bërë përpjekje që të mos hiqen shumë punëtorë nga puna”, shtoi drejtori Morina, i cili në vijim foli edhe rrëth problemeve të kësaj natyre në shkollën teknike “Fehmi Agani”. Duke folur rrëth konkursit publik, të shpallur me 14 korrik 2014, Morina shtoi se konkursi është shpallur ne ueb – faqe dhe gazetat publike që botohen në Kosovë.”Konkursi është dalë sipas Udhëzimit për normativ të MASHT-it, janë formuar komisionet, janë bërë listat e ngushta, gjithçka mendoj dhe gjithçka ka shkuar sipas atyre procedurave që

mendoj çdo gjë ka shkuar sipas procedurave. Kemi marrë parime në DKA, pa emra pa kurrfarë dallimesh politike, fetare, ngjyrave, të shtresave shoqërore, sidomos ata që kanë punuar në vitet e 90, edhe ata që kanë pasur përvojë, të cilëve iu vlen diploma përkatëse sipas Udhëzimit 9/2014, të mbeten në punë. Kjo ka qenë një bazë ligjore për arsyet se Udhëzimi 9/2014 parasitet baçelar të jenë ata që pranohen në punë dhe jo studentë dhe ndodh që në të gjitha shkollat kanë mbetur arsimtarë që nuk e kanë kualifikimin, përkatësisht të cilët nuk kanë qenë të “trezikuar” me diplomën. Gjitha rastet tjera janë përbushur në rregull, kanë mbetur papunë një numër i vogël të cilët janë rezikuar pa diploma përkatëse sipas Udhëzimit 9/2014. Çdo gjë ka qenë në rregull. Më vonë janë bërë disa zëvendësimë të cilat komuna ka mundësi t'i bëjë, zëvendësimë që është përmend edhe në gazeta pa konkurs. Është e vërtetë që sistemimin e bën Komuna, ka të drejtë të bëjë sistemime, mirëpo sistemime në punë në kuadër të asaj qysh duhet. Ne i kemi bërë disa sistemime të tillë me kuadër përkatës. Nga gjithë ata 400 vetë që kanë aplikuar nuk ka mbetur asnjë mësues i matematikës, ose i ciklit klasor që nuk është kualifikuar dhe normalisht në vend të tij është marrë dikush tjetër, sepse nuk ka pasur të tjerë, është e vërtetë. Arsimi është një proces i ndërlikuar që nuk na përket vetëm ne DKA-së, por gjithë komunës, gjithë shoqërisë, gjithë asamblistëve. Më rendësi që ai proces vazhdon, është mirë që ta japim kontributin për të mirë të gjithë, konform ligjeve, konform rregulloreve, konform institucioneve tonë që janë të pavarura dhe normalisht që monitorojnë punën tonë, natyrisht qysh keni të drejtë edhe ju të monitoroni”, konstatoi drejtori Morina.

Arben Limani, tha se të dhënat që na i dha drejtori i Arsimit ishin më pak se sipërfaqësore prej gjithë asaj që kemi kërkuar si grup, po t'i kishim ato të dhëna që i kemi kërkuar, ndoshta do të kishte qenë më lehtë, edhe me profesorin, por edhe për ne, nëse diku ka mundur të jetë ndonjë informacion të mos jetë i saktë atëherë ishte demantuar me dokumentin që na kishte ofruar DKA. “Në fakt, ne si grup kemi nxjerrë disa prej parregullsive, në numrin e shumë parregullsive që ka pasur nëpër gjitha shkollat e komunës sonë. Po fillojmë me shkollën “I. Raci” në Klinë nuk është shpallur konkurs për vende të lira të punës, edhe pse ka pasur arsimtarë që punojnë me drejtime joadekuante. Po potencoj këtu lëndën e Kulturës muzikore, një mësues lëndor dhe tjetri klasor janë marrë në punë pa konkurs publik në vitin shk. 2013/2014, ndërsa tjetri në vitin shkollor 2014/2015. Fakti tjetër në gjuhën angleze arsimtarë ka shkuar në pension nuk i është shpallur vendi, nuk e di a është shpallur konkurs publik në Gremnik meqë arsimtarja është bartur prej asaj shkolle në shkollën “I. Raci”. Në shkollën “Tre dëshmorët” në Jashanicë, një vend pune është shpallur në shkollën amë, një student i ekonomisë i padiplomuar e jep lëndën e matematikës, po ashtu nuk është publikuar në vend për gjithë angleze, një vend për mësim klasor, orët e muzikës nuk janë publikuar si dhe njëherit nuk është shpallur konkurs për drejtor të shkollës, ku këtë rol e kryen në ushtrues pa drejtim arsimor, një ekonomist. Shkolla është pa drejtor për 6 vjet, që do të thotë akoma nuk është zgjedhur drejtori i shkollës. Duke e parë këtë gjendje të nxënësve në shkollë atje shumica e prindërve, çka kemi marrë ankesa edhe prej prindërve, domethënë që fëmijët i sjellin në mënyrë të organizuar në shkollën “I. Raci” në Klinë, duke stërngruar numrin e nxënësve në secilën klasë që krijojnë kushte jo normale përmësim, krejt si pasojë e këtyre problemeve të cilat krijohen nëpër shkollat përreth. Shkolla fillore “Dëshmorët e Qëndresës” në Gllarevë, në këtë shkollo janë dhënë një arsimari 10 orë të lëndës teknologji informative pa konkurs publik, në mësuese. Në shkollën “E. Duraku” në Sferkë, orët e gjeografisë sipas konkursit, edhe pse kanë aplikuar 3 kandidatë, 3 prej tyre me drejtim adekuat, nuk janë marrë, por është pranuar kandidatja me drejtim joadekuat. Jashtë procedurave të konkursit janë pranuar edhe 3 arsimtarë të tjerë, domethënë 1 arsimtar me shkollë të mesme, i cili ka marrë orë të ndryshme, 1 jurist, edhe 1 arsimtarë për lëndën e fizikës, studente, por këtu ruhen edhe shumë orë të tjera sigurisht për ta sistemuar edhe dikë tjetër. Shkolla” Ali

Krasniqi” në Ujmirë, paralelja e ndarë në Cabiq, 1 lëndën e historisë është pranuar një arsimtar pa konkurs publik dhe në lëndën e edukatës qytetare, 10 orë biologji pa konkurs publikë, orët e matematikës nuk janë shpallur aty, domethënë lëndën e jep arsimtari pa drejtim adekuat. Në SHMT “Fehmi Agani”, aty nuk është shpallur asnjë vend i punës, ku dihet se aty ka profesorë pa drejtime adekuate. Në shkollën e mesme “L. Gurakuqi” nuk janë shpallur orët për lëndën e edukatës qytetare, në këtë normë është pranuar kuadri nga Istogu me drejtim joadekuat. Në dy vendet e publikuar është pranuar kuadri joadekuat, janë pranuar një ekonomist dhe një baçelar me drejtim fizikë. Nuk janë publikuar orët në gjuhën angleze, ku për këto orë është pranuar një punëtor me baçelar të AAB-së. Në normën e shpallur për matematikë është marrë prapë student i matematikës. Në shkollën “Motrat Qiriazi” janë shpallur disa vende, janë marrë punëtorë me drejtime jo adekuate, ndërkaq kanë mbetur punëtorë me drejtime adekuate. Në shkollën “Sh.Gjeçovi” në Zllakuqan, drejtori i shkollës nuk dimë çfarë përgatitje shkollore ka, domethënë sipas asaj që ne e kemi është me drejtim joarsimor. Në shkollën “E. Mekuli” në Caravik është shpallur konkurs pune për 12 orë për gjuhë angleze dhe për vendin tjetër të punës, 10 orë gjuhë angleze, kishte qenë mirë të mos lihen arsimtarët jashtë pune, në fakt se këtu duhet për të qenë vetëm një normë pune. Në shkollën “Zgjimi” në Gremnik ka arsimtar që në vend të diplomës ka thjeshtë vetëm një vërtetim, që do të thotë edhe 15 vjet pas luftës punon me vërtetim. Orët e anglishtes nuk janë publikuar, ka edhe punëtorë pa konkurs dhe pa drejtim adekuat. Dhe në fund një ankesë që më ka rënë në dorë të një arsimtari të Sferkës, Sadri Bali Gashi, për të mos hyrë në detaje të ankesave të shumta që kemi marrë si grup, cilën ankesë i ka drejtuar Zyrës rajonale të arsimit, domethënë inspektoratit të arsimit ku i precizon në detaje shkeljet që janë bërë në konkursin publik 5.9.2014. (Anëtari Limani lexoi ankesën e z. Sadri Bali Gashi). Sipas kësaj ankesë del që me këtë rast janë bërë shkelje të dispozitave ligjore, nënvizoi anëtari Limani në prezantimin e tij. Dhe krejt në fund anëtari Limani kërkoi për një menaxhim më të mirë të arsimit në Komunën e Klinës.

**Skënder Merturi**, tha se kam disa pyetje për drejtorin e Arsimit: “A ka baza ligjore për organizimin e kurseve nga arsimtarë të matematikës dhe lëndëve të tjera ku nxënësve iu imponohet pjesëmarrja në këto kurse, dhe diskriminimin që u bëhet atyre nxënësve që nuk marrin pjesë në ato kurse, e para. E dyta, lidhur me sistemin arsimor paralel në komunën e Klinës, a është në njoheri DKA çfarë lëndësh zhvillohen aty, çfarë mësimi zhvillohet dhe masat që do t’i ndërmarr kjo Drejtori dhe Komuna për mbikëqyrjen ose ndalimin e mësimit paralel në Komunën e Klinës. Tre, përgatitjet e stafit interviewues për mësimdhënës që punësohen. Katër, shpjegim për ndërtimin e shkollës në Këpuz, ku ne kemi votuar buxhetin dhe është faza e dytë ku askund nuk ka asnjë veprim përfazën e parë që ka kaluar, pra nuk dihet çfarë është bërë me fazën e parë”, shtoi anëtari Merturi.

**Prend Buzhala**, e dëgjova me kujdes profesorin Hajdin dhe më pëlqeu atë që tha se arsimi është një proces dhe një sfidë jo vetëm për një drejtori por për të gjithë. “Dhe prej kësaj sfide po nisem edhe unë t’i prezantoj 2-3 fakte që më përbëjnë shqetësim. Bie fjala këtu, edhe te një material që morëm nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit, ku theksohet edhe çështja e arsimit dhe e punësimit, e papunësisë etj. Dhe shqetësuese është zvogëlimi i numrit të nxënësve. Ndoshta, meqenëse është proces dhe atëherë, cila është analiza e Komunës që zvogëlohet ky numër i nxënësve. Edhe nëse jepet këtu diku Komuna e Klinës ka diku 32000 qytetarë jashtë, atëherë domethënë, po supozojmë vetëm në 5-vjeçarin e fundit sa nxënës vetëm gjatë këtyre viteve kanë braktisur arsimin ose kanë shkuar jashtë. Nuk mjaftojnë vetëm të nxirren statistikat dhe të na sillen këtu, por të merren edhe masat në këtë aspekt. Te kuadri, unë e di në DKA për 15 vite në nivel të Kosovës organizohen forma të ndryshme të seminareve, të ngritisjes, rikualifikimeve, edhe të atij kuadri mësimor që ka qenë më parë dhe kam konsideruar që ky kuadër është shumëfish më i përgatitur

së sa ai më parë, mirëpo nëse na prezantohen të dhënat që i dha Arbeni këtu është shqetësuese, sepse po na del edhe më i pakualifikuar edhe pas gjitha atyre masave që janë marrë që 15 vjet. Kisha edhe dy shqetësimë të tjera te rënia e cilësisë. Si komision për Arsim, Kulturë e Sport, ne kemi bërë një protestë për testin që është kontrolluar jo nga kuadri profesional, por nga badigardët, ata njerëzit e sekuritatis dhe kjo është një përvojë e pashembullt që ka ndodhur në Kosovë dhe kjo nuk duhet të ndodhë në këto rrëthana demokratike. Nëse vitin e kaluar ka pasur një sukses aq të lartë të testimit, pse në këtë vit atëherë ka një rënje drastike. Kjo është shqetësuese”, nënvizoi prof Buzhala, i cili në vijim shtoi se po shoh që Komunës po i mungojnë analizat si proces, për pa perspektivën e të rinjve dhe nxënësve, sidomos të të rinjve që kanë edhe magjistratura dhe kualifikime të larta, ndërsa punojnë si kamerierë ose janë të papunë momentalisht, a ka projekte Komuna që t'u përgjigjet kërkesave të këtyre të rinjve. “Te mësimi paralel unë e kam të drejtpërdrejtë pyetjen: a është i inkluadruar arsimi i nxënësve serb në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës”, konstatoi prof. Buzhala.

Fadil Gashi, tha se interpelanca është një e drejtë edhe e opozitës edhe e Kuvendit. Po ta dëgjojmë fjalën e drejtorit shihet se gjithçka në arsim është mirë, nuk kemi nevojë për të debatuar, për të pyetur. Dhe kjo tregon më së miri në shkresën tonë që sot për çudi shërbimi na i sjell shkresat tona që ne ju kemi dërguar ajo na i kthen ne, që kishte për të ndodhur e kundërtë, është dashur të ndodh, për të na i sjellë drejtoria më shkrim. Një, që e tha drejtori në seancën e kaluar se unë jam duke iu përgjigjur pyetjeve të juaja dhe do t'i keni për seancën e radhës, kështu ka qenë në seancën e fundit. Sot që po debatojmë për çështje të arsimit, secili prej jush shkonë në Shkollën Teknike Profesionale, edhe sot nuk kanë orar zyrtar të mësimit dhe nuk dinë cilat tekste kanë për t'i blerë, jemi gati në përfundim të gjysmëvjetorit të parë. Shkeljet që janë bërë në konkurs, shtoi anëtarë Gashi, pa hyrë në ato ilegale jashtë konkursit që janë bërë, edhe Ministria ka rolin e vet, ose të fajit, ose të ndikimit të saj karshi përgjegjësive që ka, sepse këtu luhet më dy standarde: në Malishevë ku NISMA ia heq personalin e PDK-së prej pune, Ministria merr masa, formon komisione ministrore, inspektorate, edhe i dërgon për t'i verifikuar gjendjen. Komunat tjera ku udhëheq PDK-ja i mbështet Ministria edhe karshi shkeljeve që janë. Këto janë dy standarde që luan edhe Ministria në këtë rast. Që kishte qenë mirë edhe për t'i parë komunat tjera, sepse edhe DKA dhe secila komunë në Kosovë është mirë për të pasur përkujdesje për personelin arsimor”, theksoi anëtarë Gashi i cili në vazhdim potencoi edhe shumë dukuri të tjera që bëhen në arsim, çështja e pranimit të kuadrore joprofesional dhe marrja e tyre për një pagë, pastaj për klasat e XIII-ta ku plot profesorë kanë mbetur jashtë, pastaj rastin e disa nxënësve të gjimnazit të cilët prej 27 nxënësve vetëm 5 kanë ditur alfabetin e gjuhës etj. “Kjo është gjendja në arsimin tonë, që keni edhe ju edhe në drejtor. Është mirë të na sqarojë drejtoria, a ka shkresë për Zyrës regionale, qoftë prej Ministrisë për 60 diploma të kontestuara që janë në Komunën e Klinës. Dhe nëse është kjo prapë është shqetësuese për gjithë ne, për gjithë nxënësit, për gjithë personelin arsimor. Jo rastësish 3 familje të Qupevës i bien nxënësit në Klinë, prej Volljakut i bien nxënësit në Klinë. Janë dy profesorë të regionit të Jashanicës i bien nxënësit në Klinë, se nuk i lënë në shkollë të vet. Keni edhe plot fshatra të tjerë, Gremniku 20 apo 30, i bien në Klinë, sepse ka rënë niveli në shkollat e fshatrave sidomos ato ku janë paralele e nuk janë amë. Që 5 vjet nuk keni drejtor të shkollës në Jashanicë, por me ushtrues detyre dhe akoma nuk ka drejtorë. Për 17 herë thyhet shkolla në Jashanicë. A ka ndonjë përgjegjësi, a jep kush përgjegjësi? Janë vjedhur 20 lapë topë në shkollën “I. Raci”, a ka dhënë ndokush përgjegjësi. Dikush është dashur të jap, edhe kjo është pjesë e drejtorisë, e angazhimit që duhet për të pasur. Arbeni prezantoi vetëm një shkresë, ka të shumta. I kanë sistemuar të gjithë zyrtarët pa përjashtim, të vetët: akraba, kushërinj, partisë që i takojnë, baba vajzën, djali babën, vëllai motrën, më larg nuk shkojnë. Kur të doni mund të hymë me

emra, sepse kështu janë pranuar. Përgatitjeve adekuate i nënshtrohem i rreptësish, mirëpo po marr studentë dhe po dërgoj të jap mësim në shkollë të mesme vërtet është absurd. Në shkollë të mesme keni 2 studentë që jasin mësim, e mos pyet se çfarë bëhet nëpër lokalitetë tjera. Prandaj, edhe kjo interpelancë më shumë le të shërbejë më një angazhim tjetër për heqjen dorë prej politikës. Merreni njerëz me diploma adekuate, mos merrni me diploma të kontestuara, merrni njerëz që e ndjejnë në shpirt dhënien e mësimit, e jo njerëz që nuk dallohet kolleri prej profesorit as profesori prej kollerit. Prandaj e kemi këtë cilësi, e kemi këtë nivel. Më i rendësishëm është procesi për të qenë i cilësisë së mirë dhe të mos dallohet shumë ngjyra, le të jetë edhe ndonjë i ngjyrave tjera politike, gjithmonë nëse ka diplomë. Edhe unë kam qenë në koalicion, por nuk i kam thënë kryetarit për asnjë që nuk ka qenë i pakualifikuar, por i kam thënë nëse mund të sistemohen me drejtime adekuate mirë, asnjëherë nuk e kam bërë problem për ndonjë militant të LDK-së që s'ka pasur përgatitje dhe gjithqysh ai duhet të hyjë. Kjo juve ju kanë ndodhur dhe përgjegjësitë duhet për t'i marrë. Sido që të jetë unë kërkoi që të merren masa edhe Komuna ka mundësi të menaxhojë dhe ka mundësi për ta përmirësuar këtë gjendje”, nën vizori anëtarë Gashi.

**Tunë Dedaj**, tha se desha të inkuadrohem në këtë drejtim se u fol që në shkollën “Ismet Raci” ka klasë me 40 nxënës. Është shumë e vërtetë, edhe unë jam i informuar, por mund t’ju them që në shkollën “Motrat Qiriazi” janë dy klasë që nuk kanë mbi 10 nxënës. Prandaj kisha kërkuar nga drejtori i DKA-së që të ndërmarr diçka që ka mundësi për t’u shuar ato klasë. E potencoi edhe Fadili flitet që një numër bukur i madh i mësimdhënësve që janë më diploma të dyshuara që jasin mësim nëpër shkolla. Kisha për të kërkuar edhe pre drejtorit edhe prej kryetarit ta obligojë drejtorin t’i verifikojë ato diploma, nëse dalin gjitha në rregull nuk është asnjë problem, ndërsa po që se ka të tillë me diploma jo në rregull, është mirë që të mos jap mësim, sepse i nxjerr fëmijët të çalë, nuk i nxjerrë të arsimuar”, tha anëtarë Dedaj.

**Enver Gashi**, tha se kam dy pyetje për drejtorin e DKA: shumë arsimtarë janë me kualifikim bacilar katërvjeçar, ndryshimi i pagave ende nuk është bërë. Kur do të bëhet ndryshimi? Pyetja e dytë: shkolla e mesme e ultë e Cabiqit dhe e Volljakut kanë bërë kërkesë për pavarësim nga shkollat amë, cila është gjendja të na jepet një njoftim”, tha Gashi.

**Marije Selmani**, tha se kam një shqetësim rreth listës së pagave të arsimtarëve, ku këtë shqetësim e kemi shprehur edhe përmes drejtorit të shkollës, nuk di nëse e ka prezantuar çështjen. Domethënë është një diferenca shumë e vogël në mes atyre arsimtarëve me diploma fakulteti edhe që kanë punuar 30 vite, mes atyre arsimtarëve që kanë punuar 10 vite, edhe nuk kanë pasur kualifikim përkatës.

**Ndue Shabanaj**, tha se në këtë temë që është ngritur këtu, në këtë interpelancë dhe për këtë debat që po zhvillojmë këtu, pa nevojë ndoshta edhe të zgjatet diskutimi, nganjëherë kam përshtypjen se është një thënie në biologji, ”Duke analizuar lisin, mos e humbim kuptimin e pyllit, ai rritet në pyll”. Domethënë se unë pajtohem se ka edhe lëshime, edhe gabime, pajtohem se mund të ketë edhe mungesë të suksesit, por kur dëgjon në këtë interpelancë këtë debat të zhvilluar këtu, më duket se ofendojmë një pjesë shumë të madhe, masovike do të them, pjesën dërmuese të nxënësve dhe arsimtarëve të cilët punojnë në të gjitha nivelet e shkollimit në Komunën e Klinës. Mund të ketë nxënës që nuk e di as alfabetin, nuk e përjashtoj këtë mundësi, por shtrohet pyetja: mbi çfarë baze të programit ka punuar ai profesor i cili në shkollën e mesme e pyet nxënësin përfundimtar. Çështje tjetër është se mund të ketë nxënës të dobët në ndonjë shkollë ose paralele të veçanta. Punoj në shkollën e mesme “L. Gurakuqi, ky është viti 36 i punës sime në arsim, prej tyre vetëm dy vite kam qenë drejtor, të tjerat vite i kam punë me ditar. Para gjithëve jam i hapur për të gjithë se kam kënaqësinë t’u jap mësim pjesës dërmuese të nxënësve në gjimnazin “Luigj Gurakuqi”. Është kënaqësi dhe unë kam përgjegjësi, së bashku me kënaqësinë edhe përgjegjësinë. Aq shumë ka nxënës të

mirë, aq shumë ka nxënës të përgatitur, aq shumë ka nxënës të rregullt, që besoj ju hymë në hak atyre nëse dominon në temën tonë biseda për nxënësit e dobët, për dobësitë që janë në arsim, për ndonjë ngecje, që realisht unë nuk mund ta kontestoj absolutisht. Bashkë me nxënës dëshiroj të potencojoj pjesën dërmuese të punonjësve të arsimit, që punojnë me sakrificë dhe përkushtim të rrallë dhe arrin rezultate që janë të pranueshme që janë në nivel të Republikës së Kosovës. Gjimnazi në Klinë ka krijuar traditë në nivel të Kosovës dhe është në mesin e shkollave më të respektuara edhe për kritere të vlerësimit, edhe për suksesin, edhe për rezultatin. Prandaj, një fakt që duhet të na gjëzojë është mirë edhe atë ta potencojmë edhe pse ne po analizojmë në kuadër të kësaj interpellancë që më tepër vihen në pah dobësitë dhe ngecjet që mund të jenë evidente. Nuk jam në mbrojtje të parregullsisë pavarësish kush janë në pozitë, kush është në pushtetin lokal. Dihet fort mirë mënyra e pranimit të kuadrit, dihet institucioni i konkursit, dihen fort mirë të gjitha ato që është e tepërt t'i përmend këtu, as në raport me drejtorin, as me të tjerët. Për rastet që janë evidente dhe mund të ketë shkelje jam për tejkalim sa më të shpejtë të këtyre parregullsive që janë, unë nuk mund t'i vërtetoj, t'i mohoj as t'i pohoj, për shkak se janë këto institucionet kompetente që i kanë shënimet relevante për secilin kandidat që ka konkurruar dhe natyrisht që bëjnë mbi bazën e fakteve që i kanë. Megjithatë edhe një herë tërhequr vërejtjen time që mos ta krijojmë bindjen edhe përshtypjen te qytetarët edhe as të AK-ja që gjendja është aq alarmante në arsim. Çështja e testit të maturës dëshiroj ta potenco edhe këtu, nuk kam pasur rastin ta them më herët, është bërë një gabim i madh, një akuzë e paqëndrueshme ndaj punëtorëve të arsimit gjoja kanë dështuar në administrim të testit kombëtar të provimit shtetëror të maturës. Unë nuk pajtohem kurrsesi me këtë vlerësim. Atëherë ku janë lejuar mundësitë e bashkëpunimit mes nxënësve nga niveli qendror, atëherë ka pasur lëshime edhe nga personeli arsimor dhe është lejuar një mundësi e komunikimit mes nxënësve. Këtu absolutisht nuk është dështim i punëtorëve të arsimit. Për çështje të numrit të nxënësve, ne si AK disa herë kemi potencuar këtë çështje, sidomos për shkollat e Klinës. Këto shkolla duhet gravituar sipas zonave të vendbanimit. Kemi kërkuar edhe nga DKA më herët, edhe nga drejtorët e shkollave fillore ta respektojnë këtë, që duhet të respektohet dhe është mirë të respektohet, që vërtet nuk është e tolerueshme një vend 2 shkolla që janë në Klinë diku të ketë mungesë të nxënësve, diku të ketë përbushje të nxënësve”, konstatoi prof. Shabanaj.

**Prend Buzhala**, tha se më impononi diskutimi i profesor Ndout që të inkuadrohem, me sa di, ë 2-3pika u përputhem. “Unë e çmoj shumë idealizmin e arsimtarëve dhe profesorëve në të gjitha kohërat edhe sot dhe e di që ka nxënës të mrekullueshëm bile që ua tejkalojnë gjeneratave tonë me dije dhe arsim. Mirëpo nganjëherë duhet të dalim jashtë shkollës, a është ashtu apo jo. Dhe unë po them se nuk është ashtu. Pse? Sepse prej nxënësit që po del nga aty ka çuar duart shkolla, se nuk i ka krijuar perspektivë, familja nuk i krijon perspektivë, shteti i çon duart. Kah shkon ai? Ai ose jepet mbas “shpëtimtarëve”, t'i dërgojë në ISIS ose diku tjetër, ose për t'ua mërsyer kufijve gjemborë ose për t'u endur rrugëve dhe të bëhen rrugaçë. Domethënë shoqëria jonë ka dështuar totalisht në krahasim me të e jo arsimi. Mirëpo, arsimi, ku është dështimi i tij? Dështimi i tij është për shkak se nuk është krijuar perspektivë. Nëse e konsiderojmë qenie tonë, nëse na dhemb, duhet krijuar perspektivë, ndërsa ne nuk po e konsiderojmë qenie tonë dhe ky është një dehumanizim total i arsimit në këtë aspekt. Edhe tjetra, te ai procesi që kemi bërë si komision, domethënë pse ka rënë ai test. Askund në botë testi nuk përcillet me badigard. Kush është ai që ka shpallur fajtor personelin arsimor për dështim të testit. Ne këtu nuk jemi por dikush është”, shtoi prof. Buzhala.

**Fadil Gashi**, theksoi se dua ta përkujtoj Ndue Shabanin kur kemi qenë bashkë e kemi pasur bisedë çështjen e arsimit dhe te çështja e arsimit nuk i ka pasur këto lëvdata. “Se e kemi debatuar shpesh gjendjen në arsim, bile ka qenë një kohë edhe drejtor. Dhe e ditshim pasqyrën reale të gjendjes dhe e debatonim, edhe

qysh shkonin profesorët për ngritjen e notave në Zllakuqan. Edhe absolutisht nuk e përgjithësoj që të gjitha profesorët janë dembelë, të gjithë janë të pakualifikuar. Edhe nxënësi a e ka në plan-program apo nuk e ka plan-program, që i është kërkuar alfabeti ka qenë rastësi që profesori ka ngritur një nxënës dhe ndërsa ky nxënës nuk e ka ditur ka ngritur gjithë klasën. Kujtoj që nuk e kanë në program klasa XII-të ose e X-ta alfabetin. Ai nuk e ka mësuar me kohë dhe është përcjellë ashtu, nuk është ai kontest. E dyta, prej që është kërkuar kjo interpelancë, kanë ardhur njerëz dhe më kanë thënë qysh po kërkon për ta hequr drejtorin e filan shkolle. Nëse ju kemi kërkuar interpelancë mos ju shpërndani njerëzve se LDK-ja po ju heq prej drejtorit, LDK-ja po i heq arsimtarët. Ne nuk po i heqim as nuk po i qesim askënd, mirëpo ne po bëjmë përpjekje ta nxjerrim një gjendje reale gjithmonë në kuptimin e cilësisë. Jo rastësish që potencova fshatrat që di familje që për t'i mësuar fëmijët i bien në shkollën "Ismet Raci", domethënë në shkollën që bëhet mësim. Për që bëhet mësim i sjellin këtu, prej fshatrave i bien se sepse secili për fëmijën e vet ka dëshirë për ta pasur një cilësi të mirë, në këtë kontest po e them. Te shpallja e konkurseve, aty është krim, aty është fundi i çdo gjëje që është shkelur secili kriter i mundshëm, jo në përgjithësi por diku 80 për qind", theksoi anëtarë Gashi. Ndëre Shabanaj, tha unë desha të them se "kam qenë me mua, me tjetrin e me atë tjetrin kur kemi qenë bashkë", e kur nuk kemi qenë, po ju them gjithë këtu, gjitha grupeve parlamentare dhe qytetarëve të Klinës, kam qenë dhe jam bashkë me parimin, bashkë me angazhimin parimor. Nuk jam as kam qenë kurrë dhe nuk do të jem jashtë asnje angazhimi parimor. Edhe e thashë qartë: nuk jam në mbështetje të asnje parregullsie cilado qoftë ajo. Nuk kam qenë as dje, s'do të jem as sot, as nesër. Të gjithë parregullsitë jam për t'u shqyrtau dhe jam secili për të qenë përgjegjës për parregullsitë që i ka në sferën e fushë veprimtarisë së vet. Dhe nuk ka nevojë për të me treguar ku kam qenë dhe ku jam se unë e di mirë dhe qytetarët e dinë mirë... Ju faleminderit!" - theksoi prof. Shabanaj.

Halil Desku, tha se më vjen keq që nuk prezantova nga fillimi i seancës dhe më mungojnë fjalët e disa asamblistëve që folën, mirëpo drejtorin e dëgjova deri në fund dhe drejtori, sipas mendimit tim, edhe gjithë neve, e përbushi atë që është kërkuar këtu, domethënë i tha disa detaje. Mirëpo unë do të lidhem diçka, ndoshta edhe të tjerët kanë folur për testin e maturës, mirëpo unë do ta them atë që ndjej, që u ngrit si shqetësim edhe preforma e mësimdhënësve. Që të dyja këto nuk kanë të bëjnë me rendin e ditës për një arsy, se nuk janë në kompetenca të pushtetit komunal, gjegjësish nuk janë në kompetenca të zotëri Hajdin Morinës. Drejtori duhet të flas më tepër për vete, nuk dua të hyjë në çështjet se çfarë duhet ky të jap, por meqenëse u ngritën dua të jap mendimin tim, edhe pse nuk janë në kompetenca as të drejtorit as tonat këtu. Në gjithë këtë përgjigje që ka dhënë në interpelancë drejtori, mirëpo nuk e inkurajoj shumë të marr përgjegjësi për testin e maturës dhe performancën e mësimdhënësve. Pse? Unë edhe profesor Ndou dhe shumë të tjerë këtu ka që punojnë në arsim, meqenëse e potencova emrin e Ndout, edhe për ta mbështetur, është njohës i mirë i çështjeve arsimore, ne punojmë bashkë dhe e njohim punën qysh bëhet edhe në "L. Gurakuqi", "Fehmi Agan" etj. Sa i përket testit të maturës ky test, që u ngrit si shqetësim gjoja nuk e menaxhojnë mësimdhënësit por kompanitë e sigurimit. Dua t'u them gjithë kolegëve, ajo ka qenë aksidentalish që me pak prova pa i involvuar mësimdhënësit, është vendim i MASHT-it që të shkojë nën menaxhimin e Kompanisë së Sigurimeve. Prandaj, kjo nuk ka të bëjë me kompetencat e DKA-së, as tonat. Mirëpo dua ta them një: potenco kurrikulen drejtori dhe tash sivjet i kemi 3 pilot – shkolla, që faktikisht po ndërron sistemi i shkollimit në Kosovë dhe brenda 3 vjetëve pritet për t'u implementuar. T'i harrojmë këto shqetësime rrëth testit të maturës, se me kurrikulen e re parashihen shumë teste të brendshme dhe të jashtme. Do të ketë edhe më shumë teste dhe sfida sesa tash. Pra, po i ofrohem i një sistemi të shkollimit evropian që nuk e kemi pasur deri me tash dhe prapë menaxhimi dhe gjithçka ka për të rënë në duar të

mësimdhënësve. Kjo është ajo e tëra dhe mos lodheni për të shpenzuar energji për këto punë. Sa i përket performancës së mësimdhënëses, dëgjova pak se “ka analfabetë e s’ka, ka“nxënës të dobët e s’ka” etj. Mendoj, që nuk ka shoqëri në botë që i ka gjithë mësimdhënësit, përkatësisht nxënësit të shkëlqyer. Kriteret e suksesit maten me numra, prej 1 deri në 5. Në çdo shkollë ka mësimdhënës me performancë adekuatë, që janë të shkëlqyer, po ka edhe të atillë me performancë të dobët. Prapë se prapë dua të them: nuk është përgjegjëse DKA, se nuk ka inspektor komunal që merren me matjen e performancës së mësimdhënësve. Të gjitha këto bien në nivel rajonal e deri në MASHT. Dhe kjo pritet për t’u bërë. Hap pas hapi çdo gjë do të bie në vend, dhe faktikisht çdo gjë është hierarki, prej Ministrisë së Arsimit e deri te ai nxënësi që është i fundit. Pra të mos flasim për përgjegjësi për t’i ngarkuar atij që nuk i ka. Unë inkurajoj drejtorin për gjitha ato përgjigje që ka dhënë, se ka dhënë përgjigje adekuatë dhe profesionale. Mrekulli s’ka bërë askush deri sot e as që priten shpejt, mirëpo dalë nga dalë gjerat janë duke shkuan në binarë dhe drejtori ka prezantuar një raport profesional dhe unë e inkurajoj “dhe e falënderoj”, nën vizoi profesor Desku.

**Asime Dauti**, tha se i dëgjova gjitha këto diskutime që u bënë për drejtorin Morina. “Unë e njoh që moti, edhe para luftës, edhe pas luftës. Ishte një zyrtar i lartë i arsimit, gjithmonë korrekt dhe i sinqertë për të gjithë, i barabartë, pa dallime partiake as të tjera. Sa i përket DKA-së, asnjëherë arsimi nuk ka qenë më mirë se sa është tash. Pa marrë parasysh që ka kërkesa të shumta për konkurse. Rinia jonë falë zotit diplomon për cdo ditë dhe dhjetëra ose të themi qindra. Nuk mund të themi se është gjithçka parregullsi sikur e cekën LDK-ja. Zotit Morina i uroj një arritje shumë të mirë dhe një sukses edhe më të lartë më tutje”, shtoi anëtarja Dauti.

**Hajdin Morina**, iu përgjigj çështjeve të ngritura nga ana e këshilltarëve të AK-së. Drejtori Morina theksoi se shtohet nga qasjet e juaja se arsimi vërtetë është sfidë. “Nuk është sfidë vetëm për mua, për Drejtorinë e Arsimit, por edhe për gjithë ju. Do të mundohem t’u përgjigjem sipas pyetjeve që keni parashtruar, meqenëse bukur shumë pyetje janë. E di që nuk jam para organeve tjera, por para asamblistëve që ka zgjedhur populli. Po ndalem te Arbeni, përkatësisht te shkolla Sferkës, orët e gjeografisë: është e vërtetë që për ato orë pasi ka dalë konkursi nuk kemi marrë askënd. Është e vërtetë që tha se argumentet kushtëzojnë fakte, faktet argumente, Arlida Berisha, jemi marrë vesh me drejtorin që ajo të marr 10 orë jo më shumë, mundësisht sipas kualifikimit që ka. Sepse 20 orë gjeografie i anuluam krejt për një fakt tjetër, Violeta Berisha për shembull, e Përqevës, është gjeografe, ka kualifikimin njësoj sikur Kadri Gashi. Violeta ka punuar në atë shkollë, që nja 6-7 vjet, Kadiu nuk ka punuar. Ma e drejtë ka qenë për t’u pranuar Violeta në atë drejtim, sepse Kadriu nuk ka punuar fare aty. Edhe kështu është anuluar ai vend krejt. Pastaj po dal te “I.Rraci”, u përmend muzika, se nuk është shpallur konkursi, nuk është shpallur konkursi për mësuesin Zef Preni, sepse më ka dhënë mua dhe dikujt këtu, për arsy se UA 9/14 lejon që me shkollën e mesme të lartë të muzikës për të dhënë mësim. Udhëzimi lejon, Ministria ka lejuar, unë jam gjëzuar për këtë udhëzim nuk ka pasur dëshirë ta heq mësuesin tim. Po ashtu, në atë shkollë e kemi edhe një sistemim, është me baçeler, është Fitnete Abazi, që i takon për arsy se ka pasur vend aty. Po ashtu edhe për anglishtë është e vërtetë që nuk është shpallur vendim për mësuesin Rifat Desku, për arsy se aty e kemi çuar të kualifikuar prapë, e kemi çuar prej Gremnikut, Mustafa mbiemrin e ka. Domethënë ka shkuan i diplomuar, nuk ka shkuan i padiplomuar. Në Gremnik ka pasur konkurs atje kemi çuar Enkeleta Ibishin, për të mos rrezikuar Arben Gashi, të cilit nuk e ka prurë dikush tjetër diplomë të anglishtes ai ka mbetur aty. Arsimitarët e mirë asnjë nuk është hequr nga puna po që se nuk i ka shkuan diploma përkatëse. Po që se i ka shkuan diploma është hequr edhe ai që ka punuar edhe 20 vjet, që faktikisht kemi shumë pak. Te Jashanica për ka mbetur pa drejtor, në gjysmë të korrikut ka pasur për t’iu nënshkruar kontrata Beqir Morinës sipas procedurave të

konkursit, 8/2014 të UA të MASHT-it. Beqiri kur është dashur ta nënshkruajë kontratën dhe ka zhvilluar të gjitha procedurat ka thënë se nuk mund ta nënshkruaj kontratën për arsy shëndetësore. Më vonë kemi zgjedhur ushtruesin me një arsimtar që ka punuar aty, deri në zgjedhje, përkatësisht sipas konkursit për drejtorë, që do të shpallet shpejt, edhe për disa shkolla që iu ka skaduar mandati. Orët e matematikës dhe të muzikës nuk janë shpallur. Mësuesi i muzikës ka pasur të dal në pension kah fundi i korrikut përgatitjet për konkurs janë bërë në fillim të korrikut, nuk i kemi shpallur ato orë, kemi marrë një tjetër fakt që është ekonomist, por që ka punuar aty. Te "L.Gurakuqi", e tha Fadili se aty punojnë studentë, kam marrë pjesë jo si zyrtar, s'kam qenë kompetent në komision, por ashtu shkova në gjimnaz, aty nuk ka studentë. Aty është shpallur vendi për matematikë por nuk papasur profesorë të diplomuar për t'i hequr mësimdhënësit të mëparshëm që faktikisht janë pa diplomë profesori. Po ashtu, te shkolla e profesionale teknike "Fehmi Agani", nuk janë studentë, janë drejtime jo përkatëse dhe për atë u është shpallur konkursi, Dardan Rexhepit, UBD – shkencat shkenca kompjuterike, student master dhe Fisnik Elezaj – Fakulteti ekonomik, Mirëpo që të dyve u është shpallur vendi se nuk janë me drejtime adekuate. Janë me fakultet, por sipas Udhëzimeve 9/2014 sqaron drejtimin përkatës. Nuk ka pasur drejtim adekuat dhe këta e kanë vazhduar punën. Te Ceroviku pse nuk janë shpallur 21 orë bashkë, sepse 1 arsimtar ka pasur edhe orë tjera. Janë shpallur orët e anglishtes. Tash personi që ka punuar më herët e ka diplomën. Te Zllakuqani u potencia pranimi i drejtorit të shkollës, UA që ka ekzistuar atëherë kur është pranuar drejtori në Zllakuqan nuk e ka precizuar fakultetin. E kam udhëzimin që ka ekzistuar. Aty shkruan që ai që zgjidhet për drejtor duhet ta ketë një fakultet të licencuar, të akredituar nga MASHT-i. Dhe ai ka një fakultet të licencuar, të akredituar nga MASHT-i, kur ai është pranuar. Ishte me rëndësi një pyetje nga Fadili, a ka diploma falso. Jo, edhe pse ka qenë shqetësim yni. Ne jemi duke bërë përpjekje në këtë drejtim. Nuk kemi dokument zyrtar të inspeksionit të Pejës as Prishtinës që 60 diploma i kemi falso. Nuk është e vërtetë, ne nuk e kemi. Nëse ata kanë dashur për të bërë zhurmë mediatike, është dashur të sjellin tek ne dokumentin dhe të kërkojnë nga ne që të ndërmarrim masat e nevojshme. Edhe rrëth asaj që tha Arbeni akoma në Gramnik kemi punëtorë me certifikata, mund të ketë, mund të ketë edhe në ndonjë shkollë tjetër. Mirëpo, ne i kemi kërkuar diplomat, meqenëse edhe me certifikatën që zëvendëson diplomën nuk e kontestojmë, se disave nuk u përcaktohet afati, por është në vend të diplomës. U fol edhe rrëth cilësisë, edhe ne dëshirojmë që cilësia të jetë edhe më e lartë, megjithatë edhe nuk mund të kontestohet në atë masë çfarë u tha, sepse e dimë që gjimnazi "L.Gurakuqi" nuk ka qenë asnjëherë nën mesin e tabelës në nivel Republike. Kompanitë që tashti monitoruan, normalisht ishte vendim i Ministrisë, ne nuk kemi çfarë ta kundërshtojmë se është vendim legjitim, ne mund të ankohemi, mirëpo nuk mund ta ndryshojmë. Sepse janë shfaqur parregullsi në monitorim të atij testi, edhe fatbardhësisht ka dalë rezultati që ndoshta nuk e kemi pritur. Rrëth rënies së numrit të nxënësve, e dimë që Kлина që nga viti 2005 ka rëniet të nxënësve. Ne nuk kemi bërë analiza të thella në atë drejtim, mirë po kemi vërtetuar se nuk është krejt çështje e emigracionit, por çështje e natalitetit. Prej 2005 deri me tash ka rëniet dikur prej 200-250 nxënës për 1 vit. Kjo është gjendje reale që po shkakton pastaj vështirësi edhe në paga të arsimtarëve. Skënder Merturi potencoi kurset, arsimin paralel. Arsimi zhvillohet në Videjë nuk është nën domenin tonë, kështu është, kështu është duke u zhvilluar. Kurset e arsimtarëve ne jemi duke zhvilluar biseda më MASHT-in dhe inspektoratin që ta bien një vendim ata, që do të jetë shkelje, që mësuesit të së njëjtës lëndë nxënësit e vet i thërret në kursin e të njëjtës lëndë. Vendim me shkrim nuk kemi ende, nuk është mirë kjo. Kurse të tilla zhvillohen anekënd Kosovës. Marija e tha te diferencat e pagesave, ato janë çështje të rregulluara me udhëzime të Ministrisë vetëm mund të jetë mos informim i duhur. Enver Gashi potencoi mospagesat për arsimtarët baçelar, pikërisht në këtë muaj janë dalë ato pagesa,

ndoshta ka ndonjë gabim teknik,ka mbetur ndonjë që do të rregullohet në muajin tjetër. Rreth pavarësimit të shkollës së Volljakut dhe Çabiqit, ka qenë internim i kamotshëm i DKA-së që të pavarësohen këto paralele për arsy se mësimi do të jetë më efektiv. Aty ka pasur dhe ka kritere, kemi bërë kërkësë që këto shkolla të pavarësohen, sepse janë paralelet e vetme të ndara të komunës së Klinës që i plotësojnë kushtet për një gjë të tillë dhe pritet që të dyja shpejt të pavarësohen. Numri i nxënësve të shkollës”I. Rraci” është i vërtetë, zona e mbulimit me ligj nga AK caktohet zona e mbulimit,e di që është caktuar nga AK, mirëpo apo respektohet është një sfidë e të gjithëve për arsy se tash nuk mund t’ia diktojmë as prindit pse po dërgon nxënësin në atë shkollë. Pra dëshirat e prindërve nuk po mund t’i ndalim. Kam biseduar me dy drejtorët e qytetit që të ketë bartje të nxënësve. Besoj që do të arrimë një marrëveshje”, sqaroi në përgjigjet e tij drejtori i DKA-së Hajdin Morina.

**Sokol Bashota**, tha se nuk desha për ta kaluar pa u shqyrtuar ideja e shkuarjes në një seancë të AK-së në qytetin e binjakëzuar, në Lezhë, që ka qenë e paraparë, pikërisht për shkak të kësaj interpellance nuk kemi dëshiruar që të bëhet ky debat në Shqipëri. “Jo që mund të bëjmë një performancë të keqe atje si Asamble, sado që të përplasemi mes vete nuk mund të arrijmë kapacitetet e përplasjes së subjekteve politike që kanë në Shqipëri, por çdo seance jashtë vendit nuk bart edhe implikime juridike,kështu që kemi dashur që ky debat t’i ketë edhe ato implikimet juridike për shkak se monitorohen edhe nga Ministria e Pushtetit Lokal. E dëgjova veç një kënd të vërejtjeve që u dhanë për performancën e DKA-së, realisht isha gati për ta bërë shkarkimin e drejtorit të Arsimit. Mirëpo, objektet nëse i ngrisim në sferë nuk shihen njëjtë nga të gjitha anët,por ka shumë rëndësi prej cilave kënde po i shikon ato,sidomos figurat gjeometrike të cilat nuk kanë kënde të njëjta, përkatësisht nuk janë serike, nuk shihen njëjtë. Kështu që kam ardhur deri te përfundimi realisht e kam thënë në fillim të vittit që kam udhëhequr punën e pushtetit lokal kam qenë shumë i vetëdijshëm që tetë vitet të një keqmenaxhimit të arsimit dhe gjitha çështjeve në Komunën e Klinës të udhëhequr nga LDK-ja,kam qenë shumë i vetëdijshëm se do të na duhen edhe tetë të tjera për të rregulluar ato defekte, dhe besoj se jemi në përfundim të atij sanimi të atyre defekteve të cilat kanë qenë të mëhershme. Dhe konkursi i fundit për të cilin u debatua shumë tregon më së miri se si është duke shkuar procesi i mësimit,apo i vendosjes së arsimit në binarët e duhur duke u ofruar falë të rinxve që realisht janë duke diplomuar dhe numri i tyre u potencua edhe këtu. Shyqyr zotit që numri është i madh dhe janë të rinx të reja të përgjegjshëm për punën që bëjnë,por realisht janë edhe disa defekte të trashëguara jo ndoshta për shkak të ndonjë keqmenaxhimi, por për shkak të shumë kuadrove kanë një moshë 30-35 vite në arsim dhe nuk kemi dashur që të jemi aq striktë, dua ta them publikisht, para nuk kemi dashur që njerëzit para pensionimit t’i qesim në rrugë dhe pensionohet si i punësuar,e jo si njerëz të mbetur në rrugë. Drejtori i di,qëkur ka dalë ky konkurs,edhe për drejtorë,edhe ky i fundit për mësimdhënës, i kam thirrur gjithë drejtorët në zyrë dhe për dy gjera i kam sugjeruar: të mos fshehin orë mësimore, përpos atyre kriterieve që u potencuan më herët dhe ata që dinë që në shkollën e tyre kanë arsimtarë me diploma fals të jeni të sigurt se do të jepni përgjegjësi edhe ju. Dhe ju garantoj se në shkollat e Klinës kanë për t’u respektuar kriteret profesional, edhe besoj se DKA e ka realizuar. Sa i përket spekulimeve nuk di a kam të drejtë ta quaj kështu, por do të jem ndër të parët që kisha për të ndërmarrë hapa konkret ndaj atyre që kanë diploma fals. Dhe të jeni të sigurt se nuk do të qëndrojmë duarkryq pa i hulumtuar këto raste se a qëndrojnë me të vërtetë. Në 2-3 vitet e ardhme do të kemi shumë pak nevojë për të shpallur konkurse nëpër shkolla për arsy se kanë për t’u plotësuar me kuadro adekuatë,dihet se konkursi shpallet për ata mësimdhënës që nuk janë adekuatë”, pohoi kryetari Bashota,i cili në vazhdim ngehu edhe disa çështje të tjera tematike”, pohoi kryetari Bashota.

**Fadil Gashi**, reagoi ndaj disa konstatimeve të kryetarit Bashota që kanë të bëjnë lidhur me ecuritë e arsimit

gjatë kohës kur pushteti komunal është udhëhequr nga LDK-ja. “Është tepër absurde për t’ia lënë fajin LDK-së për dështimet në arsim. Ne jemi duke folur për sot, për gjendjen aktualen arsim, jo për të kaluarën”, shtoi anëtari Gashi, i cili në vijim foli për shumë defekte që, sipas tij, janë prezentë në arsimin klinas, si çështja e diplomave fals, organizimi i kurseve të mësimdhënësve dhe imponimi që u bëhet nxënësve për të vijuar në ato kurse me kushtëzim edhe për notë, humbjen e 20 lap topave në shkollën e Klinës, thyerjen për 17 herë të shkollës së Jashanicës etj.” Gjendja është shqetësuese si për ne, ashtu edhe për ju”, shtoi në fund anëtari Gashi.

**Skënder Merturi**, theksoi se dy përgjigje nuk kam marrë.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se falënderoj grupet parlamentare për shqetësimet që kanë ngritur në fushën e arsimit dhe debatin konstruktiv të zhvilluar. “Po ashtu falënderoj edhe drejtorin e Arsimit për përgjigjet dhe sqarimet e prezantuara, po ashtu edhe kryetarin Bashota. E mbyll këtë interpellancë”, tha kryesuesi Ibishi.

**Pika e pestë: Të ndryshme.**

**Bozhidar Sharkoviq**, tha se jemi dëshmitarë se çfarë ka ndodhur në këto dhjetë ditët e fundit në bashkësinë serbe në komunën tonë. “Është gjuajtur me gurë një shtëpi në Klinë, një shtëpi në Dresnik është djegur, dhe po ashtu në qendër të Klinës është gjuajtur me gurë një shtëpi. Kisha ftuar përfaqësuesit të partive politike, që bashkërisht të gjemë zgjidhje në mënyrë që ta ndihmojmë policinë që t’i gjejnë të gjithë shkaktarët e këtyre ngjarjeve. Mendoj që këto raste askujt nuk i shërbejnë askujt, dhe mendoj që ka ardhur koha t’i japim fund, përkatësisht t’i japim një pikë këtyre gjerave. Disi mua po më duket e njëjtë t’i kuptoj këto probleme kur dëgjoj zotin Fadil Gashi kur me sa di unë thotë se 17 herë është thyer apo plaçkitur shkolla e Jashanicës. Normalisht që shtëpitë serbe janë në shenjëstër të këtyre hajnave dhe kjo nuk do të thotë që ne të gjithë së bashku të mos bëjmë që t’i zgjedhim këto probleme. Kam një propozim konkret që Kuvendi të formojë një lloj delegacioni nga anëtarët e vet dhe në një periudhë të caktuar kohore t’i vizitojmë të gjitha fshatrat serbe dhe t’i shikojmë se në çfarë kushte jeton bashkësia serbe, në mënyrë që më vonë të gjemë një zgjidhje të mundshme të mos t’i kemi probleme të tilla të përsëritura”, tha anëtari Sharkoviq.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se propozimi është i qëlluar.

**Sokol Bashota**, foli rrëth çështjes. Kryetari Bashota theksoi se dëshiroj t’i njoftoj asamblistët se i kemi takimet e rregullta të Sigurisë, ku marrin pjesë anëtarët e Këshillit të Sigurisë, policia e Kosovës, KFOR-i dhe i debatojmë të gjitha rastet. “I Kemi vizituar shpeshherë këto fshatra dhe kemi bërë thirrje që rastet të lajmërohen shpejt, në mënyrë që efikasiteti të jetë më i madh. Dua të shoh rastet e tilla në një formë tjetër. Këto raste nuk kanë implikime të urrejtjes. Rastet të tilla po ndodhin tek të gjitha komunitetet. Ne i kemi dënuar. Në disa raste është bërë përpjekje për t’u dhënë konotacione politike. Mirëpo me shumë kompetencë e theksoi se nuk janë raste me qëllime politike. Rasti i fundit, në atë shtëpi nuk banon askush dhe është shfrytëzuar ky rast dhe shtëpia nga persona keqbërës është djegur. Edhe shkollat që po janë në cak të këtyre keqbërësve ato nuk kanë roje, se ngarkohet buxheti dhe për shkak të buxhetit të kufizuar nuk kemi mundësi shkollave t’u sigurojmë roje të natës. Jam i pajtimit që të bëhet një grup i asamblistëve dhe të vizitohen, është mirë për t’i parë të gjitha komunitetet se si po jetojnë dhe ku jetojnë. Kjo gjendja ekonomike është e rendë, ndoshta më shumë tek disa të cilët nuk janë dalë nga këtu kurrë por kanë një gjendje skajshmërisht të rendë. Edhe këtu kam shikuar për t’i ndërruar politikat e kthimit, për ta ndërruar qasjen e faktorit ndërkombëtar të këtyre politikave të kthimit për arsyet se veç po i kthen qytetarët e zhvendosur, po iu nderon një shtëpi dhe po i lë pastaj barrë të institucioneve komunale, pa iu krijuar kushtet se si të jetojnë ata. Prandaj do të shohim se çfarë do të veprojmë në këtë drejtim. Sot kam një takim me shefin e UNDP-së dhe do ta ngeh edhe këtë çështje për arsyet se ndoshta edhe ana ekonomike e bën që ata të mos jetojnë këtu”,

theksoi kryetari Bashota.

Prend Buzhala, tha se përshëndes asamblistin serb për shqetësimin e tij. “Unë kam një vërejtje se ky është tepër i vonuar që një vit asnjë shqetësim tjetër nuk ka ngritur, domethënë se paska qenë gjithçka në rregull dhe del se vetëm këtyre ditëve të fundit paska diçka problem. Kur dihet se problemet sistematike të kësaj shoqëria nuk janë të dhjetë ditëve po janë të më hershme. Në këtë rast vetëm desha, se çka kemi në dorë në asamblistët në këtu? Domethënë se përveç kësaj për të shkuar dhe të vizitohen, diçka tjetër nuk kemi në dorë. Unë personalisht po e them vetëm këtë: një mesazh që të gjithë qytetarët tanë që fuqia nuk qëndron as te djegjet as te gjuajtjet me gurë por qëndron tek dinjiteti dhe tek respekti i qytetarit, aty do të jemi më të fortë, kushdo që do ta merr parasysh. Vetëm qyqarët gjuajnë, nuk gjuajnë ata që kanë një shpirt demokratik, e para. E dyta, e kuptova kryetarin shumë drejt këtu, se cilat janë angazhimet edhe të bashkësisë ndërkombëtare etj. Kosova është në një aparteid dhe izolim total ndërkombëtar. Ne nuk kemi të drejtë të lëvizim përtej Kosovës. Kosova nuk ka të drejtë të lëviz në qarkullim të mallrave etj., etj., ashtu sikur këtë liri e gjëzojnë të tjerët. Dhe dikujt që i mungon kjo liri, e tillë, e aparteudit politik, Kosovës ndërkombëtarisht, si mund ta realizojmë për të tjerët? Kjo situatë e tillë dhe ky aparteid politik dhe e ndalimit të lëvizjes së qytetarëve të Kosovës unë mendoj se është në të mirën edhe të serbëve, edhe të shqiptarëve, edhe të Europës drejtpërdrejt, sepse është një gjendje që qytetarët për durojnë që 15 vjet, pastaj edhe që 100 vjet tjetra e sa e sa, dhe kjo duhet të marr fund, në mënyrë që qytetari të jetë i dinjitetshëm, të jetojë në lëvizjen e lirë jashtë këtij aparteidi. Ai delegacion që propozohet këtu, unë i besoj qind për qind kësaj cake tha, absolutisht nuk dyshoj asgjë, nuk e di se është një gjendje e mirë vetëm ndoshta thjeshtë si ngushëllim> fenomenet po ndodhin edhe në mese të tjera, u potencua rasti i shkollës në Jashanicë dhjetëra herë është thyer një shkollë edhe në Çabiq, janë vjedhë pajisje, vjedhje masive të shtëpive, të bagëtive, të traktorëve etj. Ndoshta këtu është mirë që shteti të mos dështojë”, konstatoi prof. Buzhala.

Fadil Gashi, theksoi se “luajtja e kokës sikur tek ne sikur në Shqipëri nuk është e njëjtë”, ata kështu thonë, por ne kështu themi jo, ose e kundërtë, e para. E dyta, unë kujtoj se Kosova qartë ka përcaktuar fatin e vet për integrime, për të gjithë qytetarët e vet. Me këtë rast pjesë e këtyre proceseve është edhe Kлина që nuk dyshoj as në ekzekutivin as në këtë Kuvend që nuk është i përkushtuar për të qenë të integruar secili qytetar që është banorë i Komunës së Klinës. Por reagimi im është në atë që nganjëherë duke dashur për të bërë mirëpo shkelim procedura. Ju e dini ne kemi një komitet për komunitete ku janë gjithë subjektet. Ndoshta kishte për të qenë shumë më zyrtare, shumë më funksional, sepse ne i kemi zgjedhur vetë, edhe nuk përashtoj kushdo që i bashkohet prej ekzekutivit ose ju si kryesues. Po dua të them është zyrtarisht funksional edhe kujtoj që e kryen misionin çfarë po kërkohet ose çfarë u propozua. Mendoj që këto që i tha kryetari janë punë të organeve tona, sepse nuk është duke i dalluar as serbët as shqiptarët, as romët, as ashkalinjtë, të gjithë janë viktimi e krimít. Veprat penale ose kundërvajtjet nuk dallojnë ngjyra, në kurrfarë nuance, ai ka për qëllim përfitimin material çfarë mund të nxjerrë. Po shohim edhe në televizione, ka djegie të shtëpive prej shkaqeve të ndryshme, që në vazhdimësi ndodhin. Motivet janë diçka tjetër, ne jemi të hendikepuar për të nxjerrë në këtë rast, por sido që të jetë ne mbështesim, por mbështesim organet tona funksionale”, nënvizoi anëtarë Gashi.

Pjetër Coli, tha se ka bindjen se shumica e shtëpive që thyhen në territorin e Komunës së Klinës janë shtëpi të kurbetçarëve. Pse? Pse ato janë pa njerëz. Dhe shtëpitë që janë pa njerëz janë më të lehta për gjahun e hajnave. Edhe kjo përqindje e shtëpive të kurbetçarëve me siguri janë të kombit shqiptar. Po pajtohen të gjithë që hajni është kriminel dhe nuk ka ideale as nuk ka përkatësi çfarëdo qoftë ajo. Unë këto reagime të reja që janë për ne në Klinë këto ditë të fundit, për një shtresë të qytetarëve tanë mund të jetë një kundër

reagim i asaj çka ka ndodhur në Beograd. Por, përfaqësuesi i komunitetit serb në mesin tonë po e sheh qartë se cili është reagimi i menjëherëshëm yni si institucion për këto dukuri negative. Pra, të gjitha dukuritë negative që bëhen në territorin tonë ne si institacione do të fillojmë që nga dita e sotme me organe kompetente t'i luftojmë. Edhe këtë gatishmëri tonën si institucion është mirë që ky anëtari i këtij Kuvendit t'ju përcjellë institucioneve të shtetit të Serbisë. E vërtet që nuk jemi të thirrur të bëjmë politikë të madhe, por jemi dëshmitar që institucionet në Serbi nuk i kanë dënuar publikisht thirrjet masive në stadiumin e "Partizanit" të Beogradit për "t'i shfarosur shqiptarët!" Përkundrazi e kanë ngritur zërin edhe mediet po ashtu kanë qenë në krahun e tyre. Ky është dallimi esencial mes institucioneve të shtetit të Serbisë dhe shtetit të ri të Kosovës", vlerësoi anëtari Coli.

**Haxhi Ibishi**, dëshiroj ta bëj një diferencim në konceptin e diskutimit. "Më së pari futboll kanë luajtur Shqipëria me Serbinë, jo Kosova me Serbinë, kjo është temë tjeter. E dyta, këtu unë mendoj që atë që tha kryetari që hajnia nuk njeh as ngjyrë, as fe, as komb, as përcaktim. Pajtohem me kualifikim e Pjetër Colit se atak i parë janë objektet që nuk kanë banues dhe këtu është qëllimi përfitimit të tyre. Fadili bëri një prezantim të mirë që ma përkujtoi se kemi Komitetin për Komunitete, i cili është i gatshëm për të dalë në terren. Do t'i bashkëngjitna unë së kryesues i Kuvendit, edhe prej ekzekutivit të jetë kushdo, të gjithë do të jemi në terren, do të çojmë mesazhin që kanë përcjellë këto institucionë që 14-15 vjet, mesazhin e paqes, të tolerancës, mirëkuptimit, integrimit institucional të serbëve në komunën tonë. Gatishmërinë e ekzekutivit që serbët të janë pjesë integrale e vendimmarrjes e jo vetëm e përfaqësimit, por edhe vendimmarrjes, prandaj kjo në Klinë është temë e kaluar. Unë mendoj që edhe serbët lokal e kanë dhënë këtë kontribut dhe mendoj që Kлина është duke hapëruar drejt asaj që quhet "Europë demokratike", "Europë e integruar", ku shqiptarët, serbët dhe qytetarët e R. së Kosovës do të janë të barabartë dhe do të ndjejnë veten krenarë para të tjerëve", vlerësoi kryesuesi Ibishi.

**Skënder Merturi**, tha se sa i përket propozimit të asamblistit jam në dakord, por të mos ketë dallime."E potencoi edhe Fadili atë Komitetin për Komunitete që ekziston, prandaj t'i vizitojmë të gjitha. Ne e dimë që ka edhe shqiptarë që jetojnë në kushte të vështira, ka edhe romë që jetojnë në kushte të vështira, familje të dëshmorëve e tjerë, atëherë të shkojmë dhe t'i vizitojmë të gjithë, mos të bëjmë përçarje ose ndarje ta vizitojmë veç komunitetin serb. Si Klinë jemi treguar shumë tolerantë, mund të them edhe shumë demokratik për pranimin e serbëve, përkatësisht kthimin e serbëve. S qytetarë të Klinës jemi treguar shumë zemërgjere duke i përfshirë ato që ata i kanë bërë në të kaluarën. Jam në dakord për atë që të krijohet, në këtë rast veç e kemi Komitetin për Komunitete, edhe është e arsyeshme nëse zgjerohet me anëtarë të asamblesë, por veç në vizita të mos ketë dallime, të mos vizitohet vetëm komuniteti serb, por t'i përfshimë të gjitha komunitetet. Dhe ne i dënojmë ato djegjet e shtëpive dhe fyerjet që janë bërë, por nuk janë cak vetëm shtëpitë të tyre, por edhe të shqiptarëve, të serbëve dhe komuniteteve tjera djegën. Nuk ka asgjë të keqe nëse ne vazhdojmë në këtë drejtim", theksoi anëtari Merturi.

**Tunë Dedaj**, tha se vetëm desha t'ju informoj si anëtari i Komitetit për Komunitete tek ne nuk ka pasur ndonjë lajmërim të tillë. Mbledhja ka qenë para 7-8 ditëve, kjo po ndodh sot. Rastet i dënojmë, por derisa nuk zbulohen kush i ka bërë ato, ato janë të pasqaruara. Kanë mundur të djegën edhe prej rrymës. Unë e shoh lëvizjen e lirë të qytetarëve serbe dhe malazezë dhe të tjerë që është e barabartë me të shqiptarëve në Komunën e Klinës dhe gjëzohem për këtë fakt. Pse ka ndodhur një djegie e një shtëpie nuk është mirë për t'i dhënë ngjyrë politike, por është mirë që kjo të izolohet dhe të kalohet. Vetëm desha të them dhe pajtohem me kryetarin se hajnat nuk e zgjedhin nacionalitetin kujt duan t'ia thyejnë shtëpinë. Në fshatin tim, përkatësisht afër fshatit tim në Polce është thyer një shtëpi, i është vjedhur traktori edhe gjeneratori dhe

gjësende tjera. Mirëpo, hajna ka edhe jashtë Kosovës, ka kudo edhe në vende te tjera. Ne duhet angazhuar deri në maksimum për t'i zbuluar dhe për t'i dënuar ato hajni që bëhen”, theksoi anëtari Dedaj.

**Haxhi Ibishi**, tha se duke qenë në të njëjtat valome këshilltarin e nacionalitetit serb këtu, duke e parë gatishmërinë e të gjithëve dënohet si akte dhune, akte vandale, jo vetëm të një komuniteti, por të gjithë gjitha komuniteteve, ato djegjet, ato hajnitë që janë bërë. “Mendoj që edhe Asambleja është e gatshme për ta bërë një dënim të tillë publik të atij vandalizmi. Edhe në propozimin që ma kujtoj Fadili, është Komiteti për Komunitete, ne mund t'i bashkëngjitet, edhe dikush tjetër kush ka propozim. A pajtohem që si Asamble të dënojmë aktet e tillë dhune si të përgjithshme, pastaj t'i japim mandatin Komitetit për Komunitete edhe që të bëjë vizita shtesë”, shtoi kryesuesi.

**Fadil Gashi**, tha se sinqerisht nëse kjo seancë duhet për t'u deklaruar për çfarëdo, është mirë edhe atë fjalë atë term për ta gjetur. “Hajni e zgjedh vetëm viktimin, nuk i zgjedh ngjyrat tjera. E dyta, nëse duhet për t'u deklaruar, ne duhet për t'u deklaruar me një kërkesës për organet tona që të janë karshi përgjegjësive edhe obligimeve që i kanë në zënien e kryerësve të autorëve të veprave të tillë, edhe për të kërkuar që të zbardhen këto, sepse nuk e ka dalluar asnjë komunitet. Këto dukuri janë shqetësuese nëse janë për Komunën e Klinës, për qytetarët e vet, sepse nëse janë minoritetet në pyetje Komuna e Klinës ka dhënë shembullin e parë në nivel të Kosovës, kur ka bërë kthimin urban Klina ka qenë e para në të gjitha qytetet e Kosovës”, shtoi anëtari Gashi.

**Qamile Qitaku**, tha se si pjesë e atij komiteti desha të deklarohem, do t'i bëj një ftesë njëkohësisht kolegut, që edhe ai të bashkëpunojë me neve se vërtet vizitojmë të gjitha komunitetet pa përjashtim. “Ne do t'i vizitojmë, nuk është sot kjo iniciativë por gjithherë, ble kemi kërkuar edhe nga Zyra komuniteteve që të bashkëpunojë me ne në mënyrë që të kemi informata më të shumta, pastaj të dalim ne dhe të raportojmë në këtë Kuvend, që po shihet se është tejet serioz, dhe ne do të kemi qasje të drejtpërdrejtë, por gjithmonë kur kemi të dhëna se çfarë po ndodh, kur kemi parasysh që, siç u shpreh kryetari, 80 për qind janë të zbuluara dhe se nuk kanë implikime politike, apo të urrejtjes. Ne do t'i vizitojmë dhe kur të marrim vesh në bashkëpunim edhe me policinë atëherë mund të dënojmë. Kështu vërtet hajnia dënohet gjithsesi, mirëpo tash për tash vetëm mund të flasim hipotetikisht kur nuk kemi asnjë të dhënë tjetër. I bëj ftesë kolegut që të na bashkëngjitet dhe ne jemi të gatshëm për t'i vizituar të gjithë komunitetet sikurse edhe kemi vepruar”, theksoi anëtarja Qitaku.

**Sokol Bashota**, tha se prej zyrës sime e dënojmë si akt, edhe djegien e kësaj shtëpie dhe të gjitha rastet e natyrave të hajnive. “Më rendësi që rastet nuk janë të nxitura politikisht dhe me tendencë të urrejtjes. Në qoftë se vlerësojmë se këto po zbulohen 70-80 për qind, kjo do të thotë se edhe atyre po ju ngushtohet shumë hapësira. Shtëpitë që janë pa pronarë janë potencial realë për hajnat. Ka pasur edhe kualifikime që sa herë po shtrohet ndonjë çështje e Kosovës qoftë në Strasburg, qoftë në Bruksel ndodh diçka në Klinë politikisht. Të mos harrojmë edhe një, që edhe shërbimet e Serbisë veprojnë në Kosovë, shërbimet e fshehta, ta kemi parasysh këtë. Jo të gjithë sikur asamblisti që njeh institucionet e Kosovës, nuk i njohin të gjithë, ka të atillë me ngarkesa nga qendra e Beogradit dhe kryesisht të tillët i kanë bërë disa vepra në mënyrë që për të krijuar një jostabilitet në Kosovë, sikurse ka edhe “patriotë” nga shqiptarët, të cilët, siç shprehet populli, “këqyrin pas lame” dhe veprojnë akte të tillë. Kështu që të dyja ato janë me qëllim shumë të ulëta që nuk ia duan perspektivën e Kosovës, po pavarësisht tyre Kosova po ecë sigurt drejt jetësimit të pavarësimit të saj dhe njohjes ndërkombëtare drejt integrimeve euro-atlantike dhe një kontribut shumë të çmueshmë janë duke e dhënë të gjithë ata qytetarë të minoritetit serb të cilët dëshirojnë të kthehen dhe të jetojnë në Kosovë. Mos të harrojmë edhe një, nuk ka asnjë vend në botë që është etnikisht i pastër, prandaj nuk do të jetë as Kosova.

Të gjithë janë të barabartë para ligjit, gjithë ata që kanë probleme për të kaluarën e tyre mos të harrojnë se nuk harrohen. Prandaj, këtu jemi të interesuar për t'i ftuar gjithë ata qytetarë të cilët dëshirojnë për të jetuar në Kosovë. Ne çdo gjë mund të bëjmë, mirëpo vetëm gabimet e Serbisë nuk guxojmë t'i bëjmë. Ajo ka dhënë mësimin jo vetëm Kosovës, mirëpo gjithë botës, se si nuk duhet një shoqëri për të vepruar ndaj qytetarëve. Prandaj, ne si institucione dhe Qeveria e Kosovës jemi duke bërë një trajtim adekuat të mundshëm. Rrethanat ekonomike janë këto, po e shihni në çfarë kushtesh jetojnë të gjitha komunitetet, por të paktën për t'u munduar. Sot, pos këtij shqetësimi prita, ose kur kemi bërë buxhetin, për të kërkuar ndonjë investim kapital edhe për mjediset ku jetojnë qytetarët serbë, për arsy se dëshiroj t'i trajtoj si të barabartë të gjithë dhe ato janë para të qytetarëve tanë dhe ato duhet shkuar te qytetari dhe mendoj që së bashku kemi arritur sado pak për t'i ulur tensionet të cilat janë dhe shpeshherë u kam thënë edhe të huajve për lëvizjen e lirë, marrëdhëniet ndëretnike. E them një: "po që se nuk janë mirë rasoret, më rëndësi që nuk janë keq, më qëllimin më të mirë që të bëhen mirë këto raporte ndëretnike", u shpreh ndër të tjera kryetari Bashota. Bozhidar Sharkoviq, theksoi se kisha kërkuar nga anëtari Coli që ta tërheq deklaratën e tij, sepse këto raste nuk kanë asnjë lidhje me ndeshjen e futbollit.

**Pjetër Coli**, tha se më duket se kurrfarë deklarate të dëmshme për të cilën edhe pas fjalës sime kam menduar se nuk kam bërë që kam nevojë për ta tërhequr. "Ky është supozim imi që nuk ka mundësi askush për ta demantuar se është një dukuri që kohëve të fundit nuk është paraqitur në këtë rreth. Edhe ky është supozim i imi edhe ka qenë një apeli vetëdijshëm që kolegu ynë ta sheh se si reagojnë institucionet tonë kur ka dukuri negative që mund të kenë ndoshta prapavijë politike. Institucionet e Serbisë të cilat janë treguar shumë të dobëta në ndeshjen në fjalë. Thashë që anëtari i Kuvendit nga nacionaliteti serb mund ta përcjell një fjalë që në atë mënyrë duhet të veprojnë edhe ata në raste të tilla e jo një brohoritje për "shfarosjen e një populli" të mos dënohet publikisht nga institucionet e atij shteti", tha anëtari Coli.

**Sokol Bashota**, tha se disa herë u kualifikua gabimisht asamblisti. "Bozhidari nuk është përfaqësues i komunitetit serb këtu, ai është përfaqësues i një partie politike, por që është i nacionalitetit serb. Nuk është në emër të serbëve as Serbisë. Të kuptohet drejt kjo. Edhe realisht nuk kërkoi diçka të jashtëzakonshme. Komuniteti serb është dalë në protestë në përkrahje të shqiptarëve, veprim tepër human. Raste të tilla kanë ndodhur edhe para ndeshjes, madje nuk guxojmë assesi për t'i kualifikuar të tilla. Nuk janë këto refleksion i një hakmarrjeje politike, por çështje në terren i hajnave. Nëse mund t'i japid një porosi Bozhidarin për të shkuar në organet e Republikës së Kosovës dhe ta bëjë ndonjë kërkësë, por me ata të Serbisë nuk ka lidhje", vlerësoi kryetari Bashota.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se secili këshilltar deklarimin e vet e ka të lirë dhe publik që nuk përfaqëson gjithmonë qëndrimet politike të petkut politik që përfaqëson. Dhe këtu askush nuk ka të drejtë për të kërkuar tërheqje të diskutimit dikujt apo dikujt tjetër. Jemi të barabartë. Edhe z. Bozhidari duhet ta kuptojë se nuk duhet të tërhiqet asnjë diskutim i askujt këtu kushdo qoftë i cilës do ngjyrë politike apo nacionaliteti.

Gjithsecili është i lirshëm për të thënë fjalën e tij, është demokraci, është kohë parlamentarizmi. Prej Bozhidarin e kemi një kërkësë konkrete edhe një deklaratë publike të kryetarit. Kryetari Bashota tha se prej zyrës së tij do të bëjë një deklaratë publike rreth këtyre vandalizmave që kanë ndodhur në komunën tonë dhe ne nuk kemi nevojë për të bërë një deklaratë si asamble, por e përkrahim deklaratën e kryetarit që do ta bëjë nga zyra e tij. Kurse Bozhidari ka kërkuar konkretisht që një komision të del në terren të vlerësojë gjendjen. Ishte një propozim i një këshilltari të Kuvendit, meqenëse e kemi Komitetin për Komunitete, i përfaqësuar prej të gjitha forcave politike dhe nationale, atëherë është mirë që ai komitet të autorizohet me një vendim të kësaj asambleje dhe unë si kryesues i Kuvendit, qoftë se ka gatishmëri edhe ndonjë prej

ndonjë partie politike që nuk është e përfaqësuar në komitet të na bashkëngjitet, sepse është mirë për ta parë këtë situatë. Opcionet janë të qarta. Unë mendoj që kjo Asamble e ka atë gatishmëri për të dalë në terren, e ka mekanizmin edhe do të del në terren. A pajtohuni që Komiteti për Komunitete të jetë ai komision të vëzhgojë situatën në lokalitetet e komunës sonë. Vuri në miratim propozimin që Komiteti për Komunitete të del në terren.

**Me vota unanime u miratua propozimi.**

Kryesuesi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë.

Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 12:35 minuta.

Procesmbajtësi,  
Mikel Gojani

Kryesuesi i Kuvendit,  
Dr. Haxhi Ibishi

